



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**Prishtinë, 05 korrik 2023**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_1743\_2023**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

**Duke u bazuar në:**

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenit 15 , Nenin 25, Nenit 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 28, Paragrafi 1.24 dhe 1.25 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Nr. 05/L – 085);
- Dispozitat e Nenit 14.2 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes;
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (KEDS SH.A.), të datës 08.06.2023 për shqyrtim dhe aprovim të Planit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për Menaxhimin dhe Reduktimin e Humbjeve 2023,

**në seancën e mbajtur me datë 05 korrik 2023, nxori këtë:**

## **V E N D I M**

- I. APROVOHET - Plani i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për Menaxhimin dhe Reduktimin e Humbjeve për vitin 2023.**

## **A r s y e t i m**

- o Zyra e Rregullatorit për Energji ( në tekstin e mëtejme ZRRE) me datë 30.12.2022 ka pranuar nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (në tekstin e mëtejme: OSSH), kërkesën për aprovim të Planit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për Menaxhimin dhe Reduktimin e Humbjeve 2023.
- o Plani i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për Menaxhimin dhe Reduktimin e Humbjeve 2023 paraqet planin vjetor të zvogëlimit të humbjeve totale të OSSH në pajtim me cakun e reduktimit të humbjeve dhe lakores së humbjeve të lejuara për Periudhën e Tretë Rregullative nga ZRRE, si dhe planet zhvillimore dhe investive të OSSH.
- o Qëllimi kryesor i Planit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për Menaxhimin dhe Reduktimin e Humbjeve 2023 është që të projektojë planin e veprimit për zvogëlimin e humbjeve përmes investimeve kapitale dhe optimizimit të operimeve, si dhe pritshmërinë e zvogëlimit të humbjeve përgjatë vitit 2023.



- ZRRE me datë 01.06.2023 ka kërkuar nga KEDS që të dërgoj versionin e harmonizuar me dokumentet e fundit të aprovuara nga ZRRE.
- Gjithashtu ka kërkuar që dokumenti duhet të përmbajë analizën e humbjeve duke përfshirë vlerësimin e humbjeve teknike dhe konsumit të paautorizuar të energjisë elektrike si dhe zhvillimin dhe zbatimin e masave për reduktimin e tyre.
- KEDS me datë 08.06.2023, ka dërguar versionin e fundit të Planit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për Menaxhimin dhe Reduktimin e Humbjeve 2023.
- ZRRE me datë 29.06.2023 pas shqyrtimit të Planit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për Menaxhimin dhe Reduktimin e Humbjeve 2023 ka kërkuar nga KEDS që të bëhen ndryshimet sipas komenteve të dërguara tek OSSH.
- KEDS me datë 04.07.2023, ka dërguar përgjigjet në komentet e ZRRE-së, lidhur me planin e reduktimit të humbjeve të OSSH për vitin 2023.
- ZRRE pas vlerësimit të komenteve të KEDS ka vërejtur se në këtë dokument nuk janë përfshirë të gjitha komentet e ZRRE-së.
- –KEDS për pikën 3 të dokumentit ku thuhet se: OSSH për vitin 2023 ka vendosur objektivin e humbjeve totale 15.7%. Për të arritur objektivin, OSSH duhet të përqendrohet në investimet kapitale për zvogëlimin e humbjeve teknike dhe optimizmin e operimeve për të luftuar dhe zvogëluar humbjet jo-teknike
- ZRRE ka vlerësuar se në pikën si më lart me vendimin V\_1636\_2022, ka aprovuar Cakun e Reduktimit të Humbjeve dhe Lakoren e Humbjeve të Lejuara për Periudhën e Tretë Rregullative, ku për vitin 2023, caku i humbjeve për OSSH është 15.1%. Andaj, objektiva e humbjeve totale prej 15.87% duhet të jetë në harmoni të plotë me cakun e reduktimit të humbjeve për vitin 2023.
- KEDS është përgjegjës për pikën si më lartë, se bazuar në gjendjen reale të OSSH, planet investive dhe planet operative, humbjet në fund të 2022 që kanë qenë 16.79%, si dhe arsyeshmëritë e tjera që janë dërguar gjatë konsultimit publik të planit 2023/2027, për 2023, OSSH ka kalkuluar që në fund të vitit humbjet të jenë 15.9% e që i njëjti kalkulim është dërguar edhe në Bilancin Vjetor të Energjisë të aprovuar nga ZRRE. Në raportin e humbjeve për vitin 2023, të dërguar pas aprovimit të Planit Investiv 2023-2027, OSSH duke u bazuar në realizimet e muajve janar-maj 2023, pa ndryshuar vlerat për qershor-dhjetor 2023 ka kalkuluar se humbjet në fund të vitit 2023 do të jenë 15.87%.



- ZRRE konsideron se përgjigjia e KEDS në këtë pikë nuk pranohet për faktin se Plani i Reduktimit të Humbjeve duhet të jetë në harmoni të plotë me vendimin e ZRRE-së, për caqet dhe lakoren e reduktimit të humbjeve për OSSH prandaj ZRRE mbetet me qëndrimin e shprehur në fazën e komentimit fillestar që niveli i humbjeve për vitin 2023 duhet të jetë 15.1% prandaj propozojmë që në dokumentin bazik të vendoset tabela sipas komentit të ZRRE-së.
- Ndërsa` sa i përket pikës 3.1, të dokument, ku thuhet se: “Duhet theksuar, edhe pse nga planifikimi i projekteve investive për vitin 2023 është parashikuar zvogëlimi i humbjeve teknike për një përqindje të konsiderueshme në krahasim me humbjet teknike të regjistruara në vitin paraprak, për shkak të vonesave në procese të tenderimit dhe vonesave të shkaktuara deri në aprovimin e planit investiv 2023-2027, këto pritshmëri në ndikimin e zvogëlimit të humbjeve, janë marrë vetëm 25% e vlerës së kalkuluar në Planin Investiv 2023”;
- ZRRE ka vlerësuar se në këtë pikë të dokumentit projektet e tensionit të mesëm dhe të tensionit të ulët për tërë vitin 2023 janë projekte të bartura të cilat janë tenderuar në vitin 2021 dhe komisionimi pritet të bëhet në vitin 2023 andaj përfitimet prej 25% nuk janë të sakta dhe përmes vlerësimit është kërkuar që të korrigohet kjo vlerë në dokument.
- KEDS është përgjigjur në këtë vlerësim të ZRRE dhe përgjigjia ka qenë se “përfitimi i humbjeve nga projektet fillon pas përfundimit të investimeve dhe instalimit të njehsorëve. Meqenëse ka pasur vonesa siç është përshkruar më lartë, ne kemi konsideruar që gjatë këtij viti mund të ketë efekt 25% apo ¼ e efektit të vitit të plotë”.
- ZRRE ka vlerësuar këtë përgjigje të KEDS dhe pavarësisht vonesave potenciale të tenderimit, përgjigjia e KEDS nuk konsiderohet e pranuar për faktin se organizimi i proceseve tenderuese duhet të bëhet me kohë nga ana e KEDS dhe se plani i reduktimit të humbjeve duhet të jetë në harmoni me vendimin e ZRRE-së, për caqet dhe lakoren e reduktimit të humbjeve për OSSH. Pra, niveli vjetor i humbjeve për vitin 2023 duhet të jetë 15.1%. Prandaj, është propozuar që në dokumentin bazik të vendoset tabela sipas vlerësimit të ZRRE-së.
- Sa i përket përgjigjeve të KEDS në lidhje me komentet 3,4,5 të ZRRE-së, është vlerësuar se KEDS ka ofruar sqarimet e nevojshme të cilat janë pranuar si të tilla.
- Ndërsa lidhur me komentin nr. 6 të ZRRE-së ku thuhet se “tabela 17 duhet të harmonizohet me të dhënat në tabelën në kuadër të planit pesëvjeçar 2023-2027, KEDS është përgjigjur në këtë koment si në vijim: “Në tabelën 17 janë vendosur nga pesë dalje me humbjet më të larta në secilin distrikt, për vitin 2022 dhe kjo ka qenë kërkesë e ZRRE-së më herët, d.m.th që të vendosen disa nga daljet me humbjet më të larta për 2022 pa specifika të tjera, ndërsa në tabelën 7 (projektet e tensionit të ulët) dhe tabelën 9 (projektet e tensionit të mesëm) janë vendosur sipas planit investiv për 2023.



- o ZRRE ka vlerësuar se përgjigjet në pikën 6 si më lartë nuk ka qenë e mjaftueshme dhe është vendosur që në dokumentin bazik tabelat të harmonizohen me të dhënat e paraqitura për gjendjen aktuale të rrjetit të përshkruar në Planin Investiv 2023-2027, jo me tabelat që prezantojnë projekte investive.
- o ZRRE pas vlerësimit të dokumentit ka paraqitur edhe propozimet dhe ndryshimet e nevojshme rreth këtij dokumenti, ku pas përfshirjes së komenteve dhe propozimeve të palëve ka vlerësuar se dokumenti duhet të harmonizohet me kërkesat si më lartë, dhe obligohet KEDS që ndryshimet e kërkuara ti përfshij në dokument dhe ti dorëzon në ZRRE.
- o Bordi i ZRRE-së, pas shqyrtimit duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Vendimit i bashkëngjitet dokumenti:

- **Planit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për Menaxhimin dhe Reduktimin e Humbjeve 2023**

Bordi i ZRRE-së,

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gan Buçaj, Anëtar

Vendimi i dërgohet:

- KEDS Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji